

E ENJTE DATA 23 SHKURT 2023

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Pa dyshim, diskutimi i këtij raporti është tejet i rëndësishëm për Kuvendin, dhe jo vetëm. Të diskutosh për standardet e integritit europian, në fakt, është shumë absurde në kohën në të cilën jetojmë në Shqipëri. Të flasim për standardet e kontrollit parlamentar, të lirisë së fjalës, që ishte një nga problematikat më të mëdha të progresraportit të fundit të Bashkimit Europian, të flasim për shtetin ligjor, të flasim për demokracinë, për vlerat më të larta të Bashkimit Europian, tek i cili u themelua kjo strukturë, ndërkohë që kërkesa e opozitës dhe arsyeja pse ne jemi në këtë situatë politike është mungesa e llogaridhënies dhe e zbatimit të ligjit dhe të Kushtetutës për ngritjen e komisionit hetimor të kërkuar në mënyrë ligjore nga 1/4-ta e deputetëve, siç parashikohet në nenin 25 të Rregullores së Kuvendit dhe në nenin 77 të Kushtetutës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, refuzohet, duke u shprehur se është merak shumë i madh zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Më lejoni që tani, para qytetareve shqiptarë, të tregoj se jeni me dy standarde për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Të dashur qytetarë, Gjykata Kushtetuese ka dhënë një vendim shumë të rëndësishëm. Në maj të viti 2021 ka dhënë një vendim për nenin 262 të Kodit Penal për të drejtën për tubime. Çfarë ka thënë Gjykata Kushtetuese? Detyrimin e Kuvendit që të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, deri në hyrjen në fuqi të tij. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi brenda 6-muajve. Pra, ky parlament për këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese do të duhet të ishte shprehur brenda datës 02.12.2021. Me marrjen dijeni për këtë vendim, si deputetë, që në mars të vitit 2021 i kemi bërë kërkesë këtij parlamenti, që vendimi i Gjykatës Kushtetuese të zbatohet menjëherë. Ndaj jeni me dy standarde kur flasim për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Me urgjencë do të duhej që e drejta për tubime, e parashikuar në nenin 262 të Kodit Penal, të ishte rregulluar që në dhjetor të vitit 2021. Ne jemi tani 1 vit e 3 muaj me vonesë dhe ende nuk e kemi marrë këtë vendim. Ne jemi në shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Më pas mos e jani të më thoni se jeni duke zbatuar me urgjencë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që ky parlament nuk i zbaton këto vendime, edhe pse deputetët e kërkojnë, jo vetëm duke paraqitur një kërkesë në muajin mars, por edhe me letra të përsëritura në muajt shtator-tetor të vitit 2021. Ndaj, në mënyrë të paligjshme, në kundërshtim me Kushtetutën, në kundërshtim me Rregulloren, ju pretendoni mosngritjen e komisioneve hetimore, si një e drejtë dhe detyrim që keni në ushtrimin e funksionit themelor të Kuvendit, që është kontrolli parlamentar. Nëse flasim më pas për transparencën dhe llogaridhënien, ky Kuvend i ka humbur të dyja këto koncepte, që janë, në fakt, vlerat më të rëndësishme të integritit europian dhe të procesit të integritit europian. Më lejoni të vazhdoj më tej, pasi këtu u diskutua për ligjin për sa i përket rolit të Kuvendit në procesin e integritit europian. Patjetër, është një gjë e mirë që Kuvendi të rrisë monitorimin në procesin e negociatave me BE-në dhe të ketë një rol thelbësor në këtë proces, sepse kryefjala është gjithëpërfshirja dhe dialogu politik. Ndaj, ne kemi propozuar që të gjitha partitë parlamentare të jenë pjesë e Këshillit të Integritit Europian, sepse nuk duhet të mendojmë vetëm për sot në vendimmarrje, por edhe për 10 vjetët e

ardhshëm; duhet të mendojmë edhe për deputetët, që mund të vijnë këtu si pasojë e lëvizjeve të ndryshme, të të rinjve, të qytetarëve, të cilët mund të kenë si përfaqësues vetëm një deputet. Çfarë do të bëjmë ne? A do të jemi në këtë situatë, ku duhet të jesh patjetër me PD-në ose me PS-në, se ndryshe je i diskriminuar në të gjitha proceset e parlamentarizmit?! Ndërkohë që ne kemi kërkuar një amendament për këtë ligj, duke e parë në perspektivë sa thelbësor është dialogu politik dhe procesi gjithëpërfshirës, ai refuzohet se nuk ka asnjë argument. Patjetër duhet që shoqëria civile të përfshihet në këto procese, patjetër duhet të përfshihen edhe ekspertët. Madje në Kroaci dhe në Malin e Zi, në eksperiencat e tyre ata përfshijnë të gjitha burimet njerëzore të shteteve të tyre në procesin e integritimit evropian. Ky proces nuk është thjesht i një qeverie, ky proces është i një kombi, mbi të gjitha, dhe është e patolerueshme që amendamenti ynë refuzohet pa asnjë argument. Të mos flasim pastaj për gjithëpërfshirjen, pasi ne kemi një urdhër të Kryeministrit që daton në 2019-ën dhe nuk zbatohet, i cili ka të bëjë me format e pjesëmarrjes, imponimit dhe strukturës së institucioneve të platformës së partneritetit, me idenë se shoqëria civile në çdo acqui dhe në çdo grup kapituujsh të jetë një partnere pranë qeverisë.

Pra, duhej të ishin ngritur të gjitha tryezat e këtij partneriteti dhe të mblidheshin çdo muaj si detyrim i urdhrimit të Kryeministrit, gjë që faktikisht nuk ka ndodhur. Të mos flasim pastaj për disa nga vijat e kuqe, që vendosi progresraporti i fundit i BE-së për amnistinë fiskale, për “pasaportat e arta”, që jo vetëm të mos merren parasysh nga qeveria, të shkruara e zeza mbi të bardhë në progresraport, por të vazhdohet me insistim me këto iniciativa, të cilat cenojnë rëndë procesin e integritimit evropian. Në fakt, vendimi i fundit e thotë shumë qartë për rikthimin e Shqipërisë nën monitorim, pikërisht sepse kemi një regjim fiskal problematik. Nga kjo listë vendi ynë kishte dalë në vitin 2019, ndërkohë që kthehemi përsëri në listë në vitin 2023, duke i dhënë një goditje tjetër kësaj qeverie për sa i përket procesit të integritimit evropian. Të gjitha këto nuk janë progres, përkundrazi janë regres. Të mos flasim pastaj për korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisjes, të mos flasim për megaafërën e inceneratorëve dhe për të gjitha problematikat që, në fakt, progresraporti ishte shumë i qartë. Duke u zhveshur nga të gjitha përgjegjësitë që ne kemi dhe duke folur, mbi të gjitha, si qytetarë të Shqipërisë, pa dyshim, dhimbja më e madhe është që kemi një numër në rritje të azilkërkuësve; një dëshirë të madhe të të rinjve shqiptarë për t'u larguar nga vendi; mospasjen e shpresës, si dhe për të mos e parë këtë proces si një proces që u përket të gjithëve dhe jo disave. Shqipëria, në fakt, prioritet mbikombëtar dhe kombëtar duhet të ketë procesin e integritimit evropian, duke ndërtuar, pikë së pari, standardet europiane në parlamentin e Shqipërisë. Faleminderit!